



NJE TRAINIM PER RREZE X ME BAZE KOMPJUTERI

Eagle është një platformë inovative për Trainimet me Baze Kompjuteri, duke ju ofruar një kombinim unik të Ekspertizës së Sigurisë së Aviacionit, eksperiencë të zgjeruar trainimi, metodologjitë më të fundit në CBT, dhe teknologjinë interaktive të fjalës më të fundit.

E projektuar vecanërisht për përdoruesit e Skanerit me rreze X, EAGLE përfshin çdo aspekt të trainimit bazë dhe të përsëritjes së tij. Me modulet e testimit plotësisht interaktive, EAGLE optimizon eksperiencën e të mësuarit duke simuluar me kujdes ambientin e punës dhe duke e ekspozuar personin që trainohet ndaj një sërë kërcënimesh, duke bërë të mundur një kuptim më të thellë të ambientit të punës. EAGLE siguron një sërë kursesh që përfshijnë Hyrjen në Aviacionin Civil, Kontrolli Bazë dhe ai i Përsëritur me Rreze X, Sjelljet e Dyshimita, Vetëdije mbi Sigurinë, trainim i punonjësve të rinj për Cargo dhe Sigurinë e Përgjithshme.

E KRIJUAR NGA PROFESIONISTE TE SIGURISE SE AVIACIONIT – PER PROFESIONISTE TE SIGURISE SE AVIACIONIT

Vecantia e EAGLE qëndron tek njerëzit që qëndrojnë pas saj. EAGLE është projektuar dhe zhvilluar nga ICTS Europe Systems, pjesë e ICTS Europe, lider në botë në shërbimet e Sigurisë së Aviacionit, në bashkëpunim me QinetiQ, lider botëror në fushën e trainimeve të kompjuterizuara për Rrezet X dhe monitorimin e performancës. Duke punësuar me mijëra skanues me Rreze X nëpër botë, ICTS Europe zotëron një ekspertizë të pakrahasueshme në fushën e Rrezeve X. kjo, e kombinuar me njohuritë unike të QinetiQ, e bën EAGLE zgjedhjen profesionale.

FUNKSIONIMI

- Një kurs gjithpërfshirës Trainimi Bazë i cili kombinon teknologjinë interaktive dhe materialet multimediale.
- Testim njohurish, duke përdorur pyetje me shumë përgjigje për të vlerësuar kuptimin e materialit teorik.
- Test certifikimi, i cili mbulon si njohuritë teorike, ashtu dhe aftësinë për të zbuluar kërcënimet e fshehura në bagazhet e pasagjerit.
- Trainim modular i përsëritur plotësisht interaktiv, përfshirë modulet e ushtrimeve dhe ato të testimit Ndërfaqës Grafik të Përdoruesit i cili simulon saktësisht makinerinë e Rrezes X në terminalin e kontrollit.
- Testet e performancës, duke përdorur imazhe më të vërtetë të mëdha, për të vlerësuar aftësinë praktike për të përcaktuar prezencën dhe natyrën e mjeteve të kërcënimit në bagazhet që skanohen.
- Libraria e mjeteve të rrezikshme dhe atyre të padëmshme, përfshirë mijëra imazhe të bagazheve të skanuar të nxjerra nga prodhues të ndryshëm makinerish me Rreze X.
- Mjet për Autorin lehtësisht i përdorshëm, i cili i jep Administruesit të Sistemit pavarësi dhe kontroll të plotë mbi të gjithë përmbajtjen e trainimit, përfshirë krijimin dhe përditësimin e kurseve, mësimëve, prezantimeve, testeve dhe imazheve në Rreze X dhe atyre multimediale.
- Import dhe eksport i të dhënave nga/drejt vendeve të largëta dhe klasave të ndryshme.
- Akordim i personalizueshëm i trainimit në linjë me procedurat dhe rregulloret vendase.
- Mundësi për përmbajtje në shumë gjuhë (në gjuhë LTR/RTL MS që përmban Windows)
- Sistem raportimi që i bën të mundur instruktorëve të ndjekin performancën e punonjësve me kalimin e kohës dhe të vlerësojnë nevojat për trainim në bazë individi ose grupi.
- Sistem i brendshëm për mesazhet.

PERFITIMET

- Ulja e kohës së trainimit
- Ulja e kostos së trainimit
- Rritja e produktivitetit të biznesit, sepse punonjësit mund të trainohen gjatë turnit të tyre, përfshirë nevojat për caktimin e një kohe të vecantë për trainim.
- Rritja e kompetencës së të trainuarve, sepse përdoren vetëm imazhe të bagazheve të mëdha të nxjerra nga makineritë me Rreze X.
- Rrugë të personalizuar të të mësuarit të cilat mund të përshtaten automatikisht me profilet e përdoruesit dhe performancën e kaluar.
- Plotëson kërkesat aktuale të rregullores.
- E përshtatshme për vende të vecanta ose konfigurim në rrjet.
- Financiarisht e përbalueshme me mundësi blerjeje për tju përshtatur kërkesave buxhetore të organizatës suaj.
- Shërbim 24-orësh.
- Lokalizim i trainimit në Gjermanisht, Frengjisht, Italisht, Greqisht dhe Gjuhën Tailandeze si i Pikëkontrollit ashtu dhe të Operatorëve në HBS me Rreze X.

Eagle – Zgjidhje me një ndalesë për të gjitha nevojat tuaja për trainim në Rreze X.



BESIMI PER TE PUNUAR ME ICTS EUROPE

Për më shumë se 25 vjet, ICTS Europe ka qenë lider në kontrollin dhe përpunimin e pasagjerëve në aeroporte. Ne manaxhojmë një rrjet prej më shumë se 12,000 punonjësish i cili është shpërndarë në më shumë se 100 aeroporte dhe 4 kontinente, duke i shërbyer më shumë se 400 klientëve dhe duke përpunuar më shumë se 250 milion pasagjerë në vit. Madhësia e rrjetit tonë kontribuon në forcën e sistemit tonë dhe kjo do të thotë që ne kemi marrëdhënie të mira dhe akses tek shumë rregullatorë. Lidhja e fortë midis ICTS Europe Systems, krahut R&D të ICTS Europe, dhe divizionit tonë operacional e bëjnë sistemin tonë shumë praktik dhe eficient dhe bëjnë të mundur që ato të zhvillohen për të qënë të orientuara drejt agjentëve dhe proceseve.

KURSE SHTESE

Eagle ofron një gamë të gjerë kursesh trainimi mbi sigurinë për përmirësimin e performancës së stafit tuaj dhe për të ndihmuar organizatën tuaj për tju përshtatur kërkesave aktuale rregullatore. Këto përfshijnë kurse si: GSAT - Trainim informues mbi sigurinë e përgjithshme, **DetAct** - i cili përqëndrohet në shenja të dyshimta në Sjellje ose Paraqitje, Trainim për **Agjentet e Sigurisë** etj.

KONTAKTET

Për më shumë informacion dhe për të mësuar më shumë se si Eagle mund të ndihmojë organizatën tuaj, ju lutem na kontaktoni:

Eagle Team
ICTS Europe Systems
Lynton House, 1st floor,
7-12 Tavistock Square
London WC1H 9LT
United Kingdom
Tel.: +44 - 207 - 874 7551
Email: eagle@icts.co.uk

